



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2022:043848

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05765589

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtarja Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. M. nga ....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Mustafë Nuhiu, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës- Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e të ardhurave shtesë në bazë të kualifikimit dhe inflacionit, me vlerë të kontestit 2,435.40, jashtë shqyrtimit gjyqësor, më datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses M. M. nga ....., dhe DETYROHET e paditura Komuna e Kamenicës, që paditëses në emër të kompensimit të diferencës në pagë për kualifikim shkollor – fakultet, në lartësi 27 % të pagës bazë nga data 03.03.2019 deri më datë 22.11.2022, edhe atë për 45 muaj, shumën nga 55.35 euro për çdo muaj, këto në shumë prej 2,435.40 euro, ndërsa në emër të inflacionit prej datës 03.03.2019, për 2.7% të inflacionit, shumën prej 113.67 euro, për vitin 2020, për 0.2% të inflacionit shumën prej 10.10 euro, për vitin 2021 për 3.4% të inflacionit, shumën prej 171.76 euro, dhe për vitin (janar – tetor) 2022 shumën prej 537.19 euro, këto në shumë prej 832.72 euro, e në shumë të përgjithshme të hollave prej **3,268.12 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë, në shumë prej 154.08 euro, e kërkuar në emër të inflacionit për vitin 2017, shumën prej 75.78 euro, për vitin 2018, shumën prej 55.57 euro, dhe për vitin (janar – 3 mars) 2019, shumën prej 22.73 euro, REFUZHET SI E PA BAZUAR.

III. DETYROHET paditësja që ta paguaj diferencën e taksës gjyqësore për padi, në shumë prej 10.00 euro.

IV. DETYROHET e paditura, që paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 144.00 euro, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

## A r s y e t i m i

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datën 03.03.2022, ka paraqitur padi kundër të paditues Komuna e Kamenicës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave shtesë në bazë të kualifikimit dhe inflacionit, me vlerë të kontestit prej 2,435.40 euro. Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive të Arsimit, neni 7, paragrafi 1, pika 1.3, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr. 01/33 të datës 29.08.2008.

Përfaqësuesi i paditëses, përmes parashtresës për zgjerimin e kërkesëpadisë të dt.07.03.2023, ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që paditëses së lartcekur, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim -fakultet, në lartësi 27 % të pagës bazë për periudhen nga data 2017 deri më 2022, shumën prej 2,435.40 euro, ndërsa për inflacion për vitin 2017 deri me 2022, te caktohet eksperti përkatës për llogaritjen e shumës, e këto me me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën kanosjen e përbarimit ligjor. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 104.00 euro për përpilimin e padisë, 30.00 ne emër të taksës gjyqësore.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditëses.

E paditura përmes përgjigjes në padi, ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke shtuar se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune të e paditura, mirëpo KKAK nuk është regjistruar në MPMS-së, ashtu siq kërkohet me Udhëzimin Administrativnr.12/2021, për regjistrimin e Marrëveshjeve Kolektive, nga ky fakt nuk prodhon efekt juridik, po ashtu ka theksuar se në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.5/2017, “licenca për mësimdhënësit lëshohet për një periudhë 5 vjeqare ndërsa paditësi është me licencë të skaduar dhe të njejtit nuk kan zbatuar udhëzimin administrativ lidhur me vazhdimin e licencës, po ashtu ka theksuar se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vjetësh nga dita e paraqirtjes së padisë, ne rastin konkret për difrencën në pagë dhe inflacion ka prarshkrim. Gjykatës i ka propozuar ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditësit janë të punësuar pranë të paditurës, as paga bazë apo kompensimet e shtesave, por kontestues është fakti se a ka bazë

ligjore për kompensim të kualifikimit-licencimit shkollor për paditësit. Nuk është kontestuese se paditësja është mësimdhënëse e kualifikuar me fakultet dhe e licencuar (fakt i vërtetuar edhe nga diplomat nr.208, e dt.20.01.2015 dhe licenca e mësimdhënëses nr.100019982); dhe se e njejta për kualifikim–fakultet është paguar në shumë prej 58.32 euro ne muaj, sipas pagën bazë prej 421.00 euro, fakt i vërtetuar nga lista e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “ *kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtave subjektive të paditësve dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe Kontratës kolektive në fuqi të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 7 të kësaj Kontrate, si dhe Mendimit juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/33 i datës 29.08.2008, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata me rastin aprovimit të kërkesëpadiisë, pati parasysh dispozitën ligjore të nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe KKAK-së të datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK), dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), është paraparë se: “*Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit, këto në lartësi prej 27% të pagës bazë prej 421.00 euro, të përshkruara si në dispozitiv. Ndërsa pjesa e aprovuar për shpërblimin në bazë të inflacionit, bazën ligjore e ka në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë /Kontrata e datës 18.04.2017, ngase në nenin përkatës është përcaktuar se: “ Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë.”, e në rastin konkret gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve nga të dhënat se shkalla mesatare vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, periudhën prej 03.03.2019, për 2.7%, të inflacionit, shumë prej 113.67 euro, për vitin 2020, për 0.2% të inflacionit shumë prej 10.10 euro, për vitin 2021 për 3.4% të inflacionit, shumë prej 171.76 euro, dhe për vitin (janar – tetor) 2022, shumë prej 537.19 euro, këto në shumë prej 832.72 euro.*

Ndërsa në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/33 i datës 29.08.2008, është përcaktuar shprehimisht në pikën 4 pika se: *mësimdhënësve me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%*, qka paditësja në rastin konkret është të kualifikuar me përgatitje shkollore bachelor.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke pas parasysh provat materiale në shkresat e lëndës në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, punon si mësimdhënës, ka të kryer studimet shkollë të lartë pedagogjike dhe bachelor dhe është e licencuar si mësimdhënëse e karrierës nga MASHT, ndërsa pagën bazë e ka në shumë prej 421.00 euro.

Gjykata gjeti se paditëses i takon pjesërisht kompensimi i pagesës për gradim–diferencë për shkak të kualifikim dhe licencimit, ashtu që gjykata të njëjtës i ka aprovuar shumat e cekura në dispozitiv që përcillet me ngritje page prej 27% të pagës bazë për periudhën të përshkruar si në pikën I të dispozitivit. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë për shumat e gjykuara dhe aprovuara, gjykata ka vendosur pa nxjerrë ekspertizë përkatëse për shkak të ekonomizmit të procedurës, shumat ishin të qarta dhe lehtë të kalkulueshme për gjykatën.

Në bazë të Mendimit Juridik, me nr.prot.214/2013, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, është paraparë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës e datës 17.04.2017 dhe KKAK-së të datës 22.01.2021, ka karakter detyrues, për palët nënshkruese, në rastin konkret për të paditurën Komunën e Kamenicës për kompensimin e diferencës në bazë të licencimit.

Lidhur me pretendimet e të paditurës të parashtruar me përgjigjen në padi se KKA nuk është regjistruar në MPMS-së, ashtu siç kërkohet me Udhëzimin Administrativnr.12/2021, për regjistrimin e Marrëveshjeve Kolektive, nga ky fakt nuk prodhon efekt juridik, me tutje ka shtuar se nuk ka buxhet për zbatimin e kësaj kontrate, si dhe në bazë të nenit 12 parag.1 të Udhëzimit Administrativ nr.5/2017, sistemi i licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve ne karrierë, shihet se mësimdhënësit janë me licenca të skaduar, duke përfshirë edhe kundërshtimet tjera të cekura në përgjigjen në padi, gjykata vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme, pasi që KKAK është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave të nenit 90 Ligjit të Punës, çka nënkupton se meqë KKAK është e lidhur në nivel vendi, e njejta prodhon efekt juridik edhe ndaj komunës së Kamenicës, këtu të paditurës. Pos kësaj, edhe me nenin 2 parag.1 pika 1.1 të KKAK-së, në mënyrë shprehimore është paraparë se: “Dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit Para universitar.....”, ndërsa me pikën 1.2 të po këtij neni, është cekur se: “Dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (Komunat-DKA, KD të Universitete e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj)...”. Në interpretim të kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga KKAK, pasi që me këtë dispozitë është cekur qartë se të punësuarit por edhe punëdhënësit janë të detyruar t’i zbatojnë dispozitat e kësaj kontrate, andaj edhe të njëjtët janë përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve të cilat dalin nga KKAK-së. Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër të palës se paditur se se licencat nuk janë

valide, për gjykatën një pretendim i tillë është i pa qëndrueshëm nga fakti se sipas nenit 33 parag. 1 nën parag. 1.1 të Udhëzimit administrativ nr. 5/2017, sistemimi i licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve në karrier të gjithë mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014 u vazhdohet licencimi edhe për pesë vite, ndërsa udhëzimi në fjalë ka hyrë në fuqi me 25.04.2017.

Gjykata, pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses sa i përket kompensimit për inflacion, si në pikën II të dispozitivit, komfor nenit 87 të Ligjit të Punës të Kosovës, e refuzoi si të pa bazuar nga fakti se kërkesat e palës paditëse janë të parashkruara, respektivisht të paraqitur pas kalimit të afatit tre (3) vjeçar, ngase paditësja padinë në gjykatë e ka paraqitur me datë 03.03.2022, e që rrjedhimisht nga data 03.03.2019 është ndërprerë parashkrimi, prandaj gjykata ka vlerësuar se kërkesat e palës paditëse për inflacion i aprovoi nga data 03.03.2019 deri më datë 22.11.2022 kur KKAK, ka qenë në fuqi, pra ka prodhuar efekt juridik për palët, prandaj gjykata vlerëson se pretendimet e të paditëses se kërkesat e paditëses janë parashkruar qëndrojnë pjesërisht, e nga ky fakt edhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit.

Gjykata për kamatën ligjore prej 8% ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata, në bazë të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, ka detyruar palën paditëse që ta paguajnë diferencën e taksës gjyqësore për padi në shumë prej 10.00 euro, sipas vlerës së kontestit.

Gjykata duke patur parasysh suksesin në procedurë të paditësit dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463, parag. 1 të LPK-së dhe nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, të datës 18.03.2017, ka aprovuar pjesërisht kërkesën për shpenzimet e kërkuara nga i autorizuari i paditësit, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë, shumën prej 104.00 euro, dhe për taksë gjyqësore, shumën prej 40.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 144.00 euro.

Gjykata, nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**

**2022:043848, 31.05.2024**

Gjyqtarja  
Valbonë Dërvodeli, d.v.

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.